

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje materiale pastrimi

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39830000-9, produkte pastrimi

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.366.230 (një milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë) Lekë pa Tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Vau Dejës (Njësia e Prokurimit)** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, në masën 2 % të fondit limit , vlera 27.325 (njëzet e shtatë mijë e treqind e njëzet e pesë) lekë, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,

Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 8. Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë kryer furnizime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 20% të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Për plotësimin e këtij kriteri operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë; a) Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore, të cilat duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara ose vërtetimin për realizimin me sukses të kontratës shoqëruar me faturat tatimore të shitjes, ku të shprehen qartë datat, shumat dhe furnizimet e realizuara. b) Për furnizime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura

tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributor të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si telefon, fax, e-mail, ëebsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën e hapjes së ofertës mostra për artikujt 1,2,4,6,10,34,36,40,45,46,47,50 dhe këto produkte duhet të jenë të pajisura me Skedat Teknike, Çertifikatën e Sigurisë, Çertifikatën e Cilësisë nga Prodhuesi, Çertifikatën e Konformitetit CE. Mostrat duhet të jenë në ambalazhet origjinale dhe në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në ofertën teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi ,në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
 - Mostrat duhet të paraqiten për artikujt objekt i këtij prokurimi
 - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimit të transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave

2.4.3 Operatori ekonomik të vertetoje (me deklarate) që artikujt (solucionet) objekt prokurimi, të kene afat perdorimi të paktën 1 vit nga, moment i lidhjes së kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar dhe do te ofroje produktet e kerkuara me cilesi, pasi keto produkte do te perdoren per nevojat e institucionit , azilit, konviktit dhe shkollave brenda vitit dhe prandaj eshte e domosdoshme qe produktet te jene cilesore dhe konkretisht me afat perdorimi 1 vit.

2.4.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikate të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015/2018 ose ekuivalente (ose version të përditësuar) që i referohet objektit të prokurimit, nga Prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar. (Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokures të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit sipas kontratave të ngjashme në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për mallra të cilat ndihmojnë stafin e AK në proceset e punës së tyre të përditshme. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

1. Solucion larës dyshemeje(pllakash) - Solucion për larje pllakash dyshemeje. Te jete sa me i koncentruar (1-200 me uje) te lere arome te lehte pas larjes. Te jete prodhim me standarte te EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes. Masat nga 1 deri ne 10 litra. Te jene linja profesionale. Niveli i PH - (8+/-5%).
2. Solucion larës xhamash - Solucion për larje xhamash, me efekt të thellë pastrimi, në shishe 750 ml. Te jete prodhim me standarte te EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes.
3. Sapun i lëngshëm - Sapun likud për duar. Ambalazhimi te jete ne bidona nga 3 deri ne 5 litra.Te jete I certifikuar.Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes. Te jete antibacterial dhe me efekt zbutës për lekuren. PH 6 +- 5%
4. Solucion aromatizues për banjo - Solucion aromatik për tualete, paketim 1 liter, në gjendje të lëngshme, niveli i pH 3, te jete I pajisur me skede teknike dhe certifikate cilësie nga prodhuesi
5. Acid për pastrim - Acid për pastrim, të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Ambalazhimi në shishe plastike 1 lit. Të përmbaje në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0 - 3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Të jetë i tretshëm në ujë 100 %.Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës
6. Solucion larës EC dezinfektues - Solucion zbardhues, që përdoret për pastrimin dhe disinfektimin e tualeteve, veshjeve hidrosanitareve. Te përdoret dhe për larjen e pllakave të poshteme te tualeteve me hollim minimum nga 1-150 ne 1-200 me uje. Masat nga 1 liter deri ne 10 litra. Te jene linja profesionale. Niveli i PH - (1-2). Te jete prodhim me standarte te EU dhe i certifikuar sipas standarteve. Te kete kartat e sigurise dhe te perberjes
7. Solucion për pastrimin e smërcit/kripërave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit,

të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitaret. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.

8. Hipoklorit natriumi (Klor i lenget) ACE ose ekuivalent - Detergjent higjenizues me baze klori aktiv. Te kete aftesi shume te mira higjenizuese e heqese te njollave. Perdoret per disifektimin e banjove dhe ambjenteve te tjera te nevojshme, ambalazhim me bidon plastik 2.5 liter. Densiteti të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm³. Me permbajtje klor aktiv 3-4%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Ace ose ekuivalent.
9. Pastrues lares likuid enesh - Solucion larje enësh lëng, paketim plastik. Të jetë aktiv, cilësor në larjen e yndyrnave, të jetë i ambalazhuar me enë plastike. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika dhe të ketë analizën spektrale në ambalazhim. paketim plastik 250 gr. Vlera e pH të jetë 6 deri ne 8. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm³ deri në 1.3 gr/cm³. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
10. Solucion lares parketi- Pastrues per dysheme druri dhe parket laminat ne paketim 1 liter, hollimi 1-200 me uje, niveli i pH 8.5-9, paketimi te jete i pajisur me dozator, te jete I pajisur me skede teknike dhe certefikate cilesie nga prodhuesi
11. Zhbllokues lavamanesh xhel hidraulik me bidon 1 lt Solucion për zhbllokim lavamani, me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri.
12. Aromatik kasetash banje - Aromatik tualeti, me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e ËC-së. Paketimi të jetë në pako.
13. Aromatik per zyra spray - Deodorant ambienti me efekt aormatizues qe zgjat. Te mos jete i demshem. Produkti te jete i gatshem per perdorim. Te jete i konfeksionuar ne bombel alumini me mekanizem sprucimi me kapacitet 250-300 ml. Të jetë me aromë të këndshme, vanilje ose ekuivalente.

14. Bishta per fshesa 120 cm (metalik) me fileto te gjere - Shkopa metalik jo me të shkurtër se 120 cm me fileto te gjere. Materiali i shkopit të jetë metalik me veshje plastike. Të këtë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.
15. Bishta per fshesa 120 cm (metalik) me fileto te holle - Shkopa metalik jo me të shkurtër se 120 cm me fileto te gjere. Materiali i shkopit të jetë metalik me veshje plastike. Të këtë mekanizëm montues (efekt vidhimi) dhe shumë rezistent.
16. Shtupa pastrimi mikrofiber (profesionale) - Shtupë për larje dysHEMEJE, e përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 180 gr. Të këtë kokë plastike të filetuar për tu kapur në bisht.
17. Shtupa pastrimi pambuku per shkopa me fileto te gjere - Shtupa pambuku për larje dysHEMEJE përbërë nga fibra tekstili pambuku dhe mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. Të këtë kokë plastike të filetuar për tu kapur në bisht.
18. Lecka te medha per koridoret - Të jetë përbërë nga fibra tekstili me përbërje pambuku që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë
19. Paisje me gome dhe sfungjer per larjen e xhamave me bisht zgjatues metalik Sfungjeri të jetë i plotë dhe me material të butë për fërkimin e xhamit, pa e dëmtuar atë dhe goma të jetë elastike për pastrimin e shkumës apo solucionit në xham. Shkopi që përdoret për të mbajtur fshesën me sfungjer të jetë jo më i vogël se 25 cm dhe pesha e gjithë fshesës me sfungjer të jetë jo më e vogël se 216 gr.
20. Shpatulla kruajtese - Shpatulla kruajtese metalike per heqjen e mbeturinave ngjitese ne dysHEME.
21. Sfungjere per lavamane pako një paketim te ndryshëm. Të jetë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra. Anësoret të jenë me kanal për mbrojtjen e duarve
22. Doreza nje perdorimeshe pa puder masa M pako me 100 cope Latex pa puder, josterile, njëpërdorimshe, në masat M-L, paketim 50 copë , sipas Udhezimit te

perbashket nr 294 date 06.05.2020 te Agjensise se Prokurimit publik dhe Ministrise se Shendetsise.

23. Doreza plastike te trasha - Të jenë rezistente të mirë ndaj kimikateve të detërgjentëve dhe kimikatëve të pastrimit. Të jenë për përdorim të larjes së murit e pllakave. Të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme në përdorim dhe të padeportueshme nga lëngjet.
24. Fshesa pastrimi per shkopa me fileto te gjere Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Pesha e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
25. Furce banjo me mbajtese - Të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shume se 300 gr.
26. Furce lavamani - Furçë për pastrim efikas dhe higjienik. Bishti të jetë i përshtatshëm me pëllëmbën e dorës, fijet e furçës të jenë të forta për të pastruar sipërfaqet e vështira të lavamanit. Pesha jo më e vogël se 190 gr. Gjatësia e furçës jo më pak se 30 cm.
27. Furce merimangash me bisht Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim.
28. Kaci (loplate) plehrash plastike me bisht 70 cm të gjatë Të jetë jo më pak se 70 cm të gjatë. Kacia të ketë gjerësi 21 cm, gjatësi 29 cm, thellësi 10 cm, +/- 2 cm marzh gabimi.
29. Kova te thjeshta min 10 litra Të jetë plastike, me kapacitet min 10 Litër, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jete me volum min 10 Litër

30. Kova te thjeshta min 5 litra - Të jetë e thellë dhe të ketë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës. Kapaciteti mbajtës i kovës te jete me volum min 5 Litër.
31. Kosh plastik pa vrima (me dy doreza) 50 lt Të jetë në forma te ndryshme, me kapak nga sipër që hapet plotësisht. Të ketë dy doreza në pjesën anësore me qëllim transportimin e tij. Kapaciteti mbajtës i koshit të jetë me volum minimal 50 Litër. Të jenë shumë rezistente dhe praktike.
32. Kosha plastike me kapak (40x25x25)cm - Kosha plastike me kapak (40x25x25)cm në formë të ndryshme, pjesa e sipërme e koshit të jetë me kapak që hapet ku të vihen qeset e koshit.
33. Kosha plastike me kapak (60x40x40)cm - Kosha plastike me kapak (60x40x40)cm
34. Leter higjenike e palosur per duart - Leter per fshirje duarsh, 2 shtresa, ngjyre e bardhe (qe vendosen ne aparatet ekzistuese) ,me paketim jo me pak se 270 fije, me permasa 21x 22 cm, te jete cilesore.Produkti duhet te jete i certifikuar me certifikate kualiteti ku te pershkruhet qe eshte i pademshem per shendetin e njeriut.
35. Leter guzhine rulon per duart Të jetë fletë palosje me përberje 100% celuloze. Të jetë e paketuuar në ku ti ose në qese min 250 fije/pako. Letra të ketë mundësi thithje të lartë
36. Leter higjenike (rulon) - Leter higjenike ne jo me pak se 10 rula. (2 shtresa, me keputje, 1 top me 135 ndarje). Letra te kete ngjyre te bardhe. Duhet qe produktet e brendit te kene certifikate kualiteti. Permasat e nje topi te jene diametri 10 cm dhe lartesia 9,5 cm.
37. Peceta pastrimi dyshe Mikrofiber - Peceta pastrimi pako 2 copeshe, per fshirje pluhurash. Të jenë material 100% pambuku
38. Peceta pastrimi treshe Të jenë të paketuara në qese min 3 fije /pako. Të jenë me shumë se një përdorimeshe. Të kenë veti të mira përthithëse.
39. Qese plehrash te medha 80x110 cm Qeset do të përdoren për mbeturinat Të jenë rezistenete, me kapacitet jo më pak se 15 kg me përmasa min 80x110cm +/- 5 cm marzh gabimi. Të jenë të paketuara në formë ruloje ne numër te ndryshme fijesh. Të jetë produkt i biodegradueshëm. Te jene te pajisur me certefikate konformiteti produkti.

40. Qese plehrash te medha 70x100 cm Të jenë të paketuara në formë ruloje me min 30 fije me përmasa 70x100cm +/- 5 cm marzh gabimi. Pakoja e pakeluar në formë ruloje ne numër fijesh të ndryshme. Të jetë produkt i biodegradueshëm. Te jene te pajisur me certefikate konformiteti produkti.
41. Qese plehrash te vogla 50*60 cm - Të jenë rezistente, të kenë përmasa të ndryshme min 50x60cm +/- 5 cm marzh gabimi dhe min 30 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm. Te jete te pajisur me certefikate konformiteti produkti.
42. Tel enesh - Të jetë të rezistueshëm, të përshtatshëm për larje tenxheresh dhe kazanësh. Të jetë material që nuk ndryshket. Ambalazhimi me numër të ndryshëm në pako.
43. Peshqir per kuzhina Peshqir i cilësisë së lartë. I përbër 100% nga pambuk natyral. Punim i dendur dhe i qëndrueshëm, çka e bën të qëndroj i butë dhe të fshij shumë mire duart. Ngjyra të ndryshme.
44. Peceta per fshirje pjatash - Të jetë cilësore, të përshtatshme për pastrimin e pjatave të ndryshme, me aftësi super thithëse
45. Detergjent per larjen e sobave ekuivalent cif Detergjent per pastrimin e sobave ne forme te lengshme, me arome te lehte, niveli i PH 12.5 . Paketim 800 ml. Te jete I pajisur me Skede Teknike dhe Certefikate Sigurie
46. Detergjent per lavatrice (per rroba te bardha) 10 kg - Detergjent pluhur, i cili përdoret për larjen e rrobave të bardha. Sasia e dozimit për larje në lavatrice është 12-20 gr produkt per kg rroba.Niveli I PH 11. Te jete i pajisur me skede teknike dhe certefikate sigurie.
47. Detergjent per lavatrice (per rroba te zeza) 10 kg - Detergjent pluhur, i cili përdoret për larjen e rrobave. Sasia e dozimit për larje në lavatrice është 12-20 gr produkt per kg rroba.Niveli i PH 11. Te jete i pajisur me skede teknike dhe certefikate sigurie.
48. Detergjent per aromatizues (82 larje) Te jete i lengshem, te sherbeje per zbutjen e rrobave dhe aromatizmin e tyre, te jete me arome luleje, te zvogeloje kohen e tharjes, si dhe te ndihmoje per te pastruar dhe zvogeluar rrudhosjen e rrobave, te parandaloje zbehjen e ngjyrave.

49. Solucion per pastrimin e smërcit /kriprave për lavatriçe - Tabletat te jene te mbeshtjella individualisht, te mbrojne ne menyre active kunder gelqeres dhe mbetjeve te papastertive, te neutralizojne shkallet e gelqeres, te mbrojne te gjitha pjeset e makines larese nga demtimi i gureve te gelqeres. Ambalazhimi të jetë bërë nga fabrika në kuti kartoni trajtë tablete. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
50. Alkool etelik(Spray) - Solucion dezifektant me perberje alkooli me i madh se 60% . Te jete i pajisur me certifikate sigurie dhe skede teknike. Te jete I pajisur me deklarate nga prodhuesi qe produkti lufton coronavirusin.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 5 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.